



FORUMI MUSLIMAN I SHQIPËRISË
Rr. Sami Frashëri, p. 20/3, Ap.1,
TIRANË

Tiranë, më..... 06.2010

KALLËZIM PENAL

KALLËZUES:

Forumi Musliman i Shqipërisë, i përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. **Fisnik Kruja**.

TË KALLËZUAR:

1. **Gazeta «SOT»**, me seli në : «Rr. Sitki Çiço, përballë Maternitetit të Ri », përfaqësuar nga botuesi i saj, **Arjan Prodani**.
2. **Kastriot Myftaraj**, lindur në 02.10.1966, Kastriot Myftaraj, banues në qytetin e Tiranës, Rruga “Ali Demi”, Godina 155.

OBJEKTI:

1. **Kallëzim penal për kryerjen e veprave penale: «Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive » ; “Thirrja për urrejtje nacionale” dhe “Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik”.**
2. **Marrjen e masës së sigurimit personal “Arrest me burg” dhe “Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”; deri në gjykimin përfundimtar të kësaj çështje, ndaj shtetasit Kastriot Myftaraj;**
3. **Marrjen e masës së sigurimit të karakterit ndalues: “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”; apo “Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”; ndaj personit juridik Gazeta “SOT”, me botues Arjan Prodani.**

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 10, 24 të Kushtetutës së R. SH.; Nenet 9, 10 të KEDNJ; Nenet 25, 50, 265, 266, 267 të Kodit Penal; Nenet 283, 280 të Kodit të Procedurës Penale.

DREJTUAR: Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PËR DIJENI: Prokurores së Përgjithshme, znj. Ina Rama.

Presidentit të Republikës, z. Bamir Topi

Kryetares së Kuvendit, znj. Jozefina Topalli

Kryeministrit, z. Sali Berisha

Kryetares së Gjykatës së Lartë, znj. Shpresa Becaj

Avokatit të Popullit

Komitetit Shtetëror për Kultet

Ambasadorit të BE-së, z. Helmut Lohan

Ambasadorit të SHBA-së, z. John Withers

E nderuar Prokurore e Përgjithshme znj. Ina Rama;

Të nderuar prokurorë të Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Të nderuar zyrtarë të tjerë të lartë;

I. Çështja.

1. Në datën 25.05.2010, në njëren prej gazetave të përditshme shqiptare, Gazeta « SOT », është botuar një shkrim i shtetasit Kastriot Myftaraj, me titullin: « Ylli i kuq i Moskës dhe Guri i zi i Mekës ».
2. Në këtë artikull është shkruar, ndër të tjera:
 - i. “(...) muslimani shqiptar është armiku, me të nuk kam ç’të diskutoj, dhe me të as mund të diskutohet. Ai shfaq një barbari të thellë. Unë e urrej atë, se ai është bartës i një feje që shfaq hapur armiqësinë ndaj kombit shqiptar(...)”.
 - ii. “(...) Islami është armik i kombit shqiptar dhe bota islame e urren kombin shqiptar(...)”.
 - iii. “(...)Sot deislamizimi është sfida historike për shqiptarët, në dy anët e kufirit. Në trojet shqiptare duhet të zhbëhet çdo shenjë e Islamit(...)”.
 - iv. “(...) Ne shqiptarët duhet të ndahemi me Islamin me anë të një referendumit mbarëkombëtar, ku njerëzit duhet të pyeten për ndalimin e tij. Ky referendum duhet të bëhet me votim të hapur, si një rast i veçantë (...).
 - v. “(...) Çdo njeriu që do të deklarohet si musliman duhet t’i hiqet shtetësia e Republikës së Shqipërisë, eventualisht e Kosovës dhe të marrë statusin e emigrantit, duke u quajtur emigrant arab. Derisa në Shqipëri dhe Kosovë ka një komunitet të sajuar egjiptian, le të ketë dhe një komunitet emigrantësh arabë. (...)”.
 - vi. “(...) Nëse (referendumi) fiton në pjesën shqiptare të Maqedonisë atëherë këta njerëz le të shkojnë në drejtë, le të shkojnë tek guri i zi i Mekës, se nuk kanë çka i duhen kombit shqiptar. Për mua ata është

njëlloj sikur të jenë në Arabi (...)."

vii. "(...) Shqiptarët mund të besojnë tek Zoti pa pasur nevojë për këtë surrogat-fe të shkretëtirave, çka është Islami. Islami shqiptarëve nuk u ka sjellë veçse të këqija, dhe të këqija më të mëdha do t'u sjellë edhe në të ardhmen. Islami nuk i lidh shqiptarët me Zotin, por me idhujtari antike të shkretëtirave. (...) Ylli i kuq dhe Guri i zi takohen si simbole të së keqes. Ne nuk mund të lejojmë që fati i kombit shqiptar të rrijë edhe më tej i ndryrë si në një magji të zezë tek Guri i zi në Mekë(...)."

viii. "(...) Islami i ka shpallur luftë kombit shqiptar, duke synuar që ta mbajë të ndarë nga Perëndimi. Në këtë luftë xhamitë janë fortesat e ushtrisë armike, minaret janë tytat e topave të ushtrisë armike, islamikët praktikantë janë ushtarët armiq (...)."

3. Po ashtu, në vazhdimësi të së njëjtës linje, i njëjti autor me anë të së njëjtës të përditshme, në datën 28.05.2010 ka shkruar dhe shpërndarë shkrimin tjetër të titulluar « **Një formulë për matjen e shkallës së rrezikut të terrorizmit islamik në Shqipëri dhe Kosovë** ».

4. Në këtë artikull është shkruar, ndër të tjera:

i. "(...) Shkurt është e nevojshme një luftë preventive kundër radikalizmit islamik në Shqipëri, një luftë e ngjashme me ato që zhvillon Izraeli në Gaza, Bregun Perëndimor dhe Liban. Mënyra më efikase për zhvillimin e kësaj lufte është nxjerrja jashtë ligjit e fesë islame në Shqipëri dhe mbyllja e të gjitha objekteve të saj të kultit. Bashkësia Islame e Shqipërisë, siç quhet tash Komuniteti Musliman, mund të thotë se nuk është fajtores për atë se ka radikalë islamikë në Shqipëri, por është ekzistenca e fesë islame dhe e objekteve të saj të kultit në Shqipëri, që ka siguruar logjistikën e radikalizmit islamik në Shqipëri. Pra, jo të gjithë muslimanët shqiptarë (me muslimanë këtu kuptoj praktikanët) janë terroristë potencialë, por të gjithë terroristët nesër do të jenë muslimanë (...)."

5. Por situata u bë edhe më e rëndë, kur Komuniteti Musliman Shqiptar

depozitoi ndaj shkruarit të këtyre dy artikujve një kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në dhunim të çdo norme kushtetuese dhe ligjore, shtetasi Kastriot Myftaraj dhe Gazeta «SOT», kanë botuar një tjetër artikull që është me ekstremist se çdo ekstrem i menduar ndonjëherë jo vetëm në Republikën e Shqipërisë, por edhe në diktaturat më të egra. Konkretisht në datën 02.06.2010 është botuar shkrimi me titull: «Kur lehja e qenit ndaj hënës quhet fe».

6. Në këtë artikull është shkruar, ndër të tjera:

- "(...) qenlehja është fe legale në Shqipëri, dhe në krejt trojet shqiptare në dy anët e kufirit. Provat për këtë gjë i keni pesë herë ditën dhe natën, kur në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Shqipërisë rreth dhjetë mijë megafonë të vendosur në 2000 minare lehin arabisht. Në krejt hapësirën shqiptare në dy anët e kufirit, në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, pjesën shqiptare të Maqedonisë, Malin e Zi, Luginën e Preshevës, janë rreth gjashtë mijë minare me 25 mijë megafonë, që lehin arabisht.
- Kështu duket sikur 25 trilion qenër lehin në hapësirën shqiptare, në dy anët e kufirit, pesë herë ditën dhe natën. Megalehja teknologjike bëhet edhe më e fortë natën, kur del hëna, çka duket në pajtim me zakonet qenore, se dihet që qentë i lehin hënës. Jo më kot gjysmëhëna është simbol i Islamit. Madje, kur dëgjon këtë megalehje, të bëhet të besosh se edhe Muhametit, i cili është në origjinë të këtij rituali, nuk lejohet t' i shfaqet fytyra, se ai ka qenë një qen.
- Kjo megaqenlehje teknologjike tregon më mirë se çdo gjë se sa absurde është ekzistenca e Islamit në Shqipëri. Se këtë megaqenlehje teknologjike arabisht nuk e bëjnë një grup radikalësh islamikë. Jo, kjo megaqenlehje teknologjike është e organizuar nga institucionet legale të Islamit në hapësirën shqiptare, Bashkësia Islame e Shqipërisë (Komuniteti Musliman i Shqipërisë), Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Islame e Maqedonisë. Megaqenlehja ngrihet nga minaret e xhamive që janë në administrim të këtyre institucioneve fetare.

- Unë çdo ditë e më tepër po bindem se as që ia vlen që të bëhet dallim tek muslimanët praktikantë, ndërmjet disave të supozuar si të moderuar, ndër të cilët janë zyrtarët e Komunitetit Musliman të Shqipërisë, në një anë, dhe radikalëve në anën tjetër. Derisa megaqenlehjen arabisht e organizon dhe ekzekuton pikërisht Komuniteti Musliman i Shqipërisë, atëherë për mua edhe ai është e njëjta gjë si fundamentalistët islamikë. Çdo xhami në Shqipëri, nga e cila ngrihet kjo qenlehje teknologjike arabisht për mua është një tank i Xhihadit. Çdo minare nga e cila lehet arabisht, për mua është një top, raketë apo howitzer, i Xhihadit. Çdo megafon minareje xhamije, nga i cili lehet arabisht, për mua është një mitraloz i Xhihadit. Çdo tingull i megaqenlehjes arabisht për mua është një predhë e lëshuar nga armët e Xhihadit, mbi kombin shqiptar, mbi dinjitetin dhe ardhmërinë tonë.
- Çdo njeri për të cilin është e shtrenjtë kjo megaqenlehje arabisht, pramuslimani praktikant, për mua nuk është shqiptar, është armiku të cilin unë e urrej, dhe do ta luftoj. Derisa muslimani praktikant nuk bën dot pa këtë megaqenlehje arabisht, unë e urrej atë. Por unë do të vazhdoj që ta urrej muslimanin praktikant shqiptar edhe nëse ndalohej nga shteti kjo megaqenlehje në arabisht. Se muslimani praktikant shqiptar do të jetë i mërzitur nga ky ndalim, dhe do të mendojë dhe veprojë për ta rikthyer atë. Muslimani shqiptar, i cili është i rrezikshëm se adhuron këtë megaqenlehje, do të bëhet edhe më i rrezikshëm kur t'i mungojë ajo, se do të bëjë gjithçka për ta rikthyer atë. Muslimanët praktikantë shqiptarë, për të cilët është e shtrenjtë kjo megaqenlehje arabisht, janë Armata e Xhihadit.
- Megalehja teknologjike arabisht është Hymni i Xhihadit, i cili ushton pesë herë ditën në Shqipëri dhe në krejt trojet shqiptare. Unë e urrej fenë islame në Shqipëri se ajo është e vetëidentifikuar me këtë megaqenlehje në arabisht. Por unë do ta urreja atë edhe nëse do të ndalohej kjo megaqenlehje në arabisht, sepse ajo do ta quante dhunim këtë ndalim. Megalehjen teknologjike arabisht,

në Shqipëri e pëlqejnë dy kategori qëniesh të gjalla, muslimanët praktikantë dhe qentë. Në kohën që fillon megalehja teknologjike arabisht, fillojnë lehin të gjithë qentë në rrezen e saj. E për shkak se haxhi doktor Selim Muça, kryespecialisti i megalehjes arabisht, e ka projektuar atë në mënyrë të tillë që të mbulohet krejt territori i Shqipërisë, atëherë për pasojë fillojnë e lehin të gjithë qentë e Shqipërisë.

- A mund të pranohet pesë herë në ditë kjo megalehje arabisht, në emër të tolerancës fetare? Tolerancë ndaj kujt, ndaj njerëzve, apo ndaj qenve. Nuk ka tolerancë fetare ndaj qenve. Por kjo megalehje arabisht pranohet megjithatë në emër të tolerancës fetare. Kështu, i bie që kur qeni i leh hënës, të quhet akt fetar. Komuniteti Musliman i Shqipërisë na fyen dhe na poshtëron të gjithëve me këtë megalehje arabisht. E pastaj kryetari i Komunitetit Musliman, haxhi doktor (në megaqenlehje teknologjike), Selim Muça, kryeshefi i Xhihadit teknologjik në Shqipëri, ngrihet dhe bën kallzim penal ndaj meje për nxitje të urrejtjes ndaj fesë islame, thirrje për urrejtje nacionale, përhapje të informative që shkaktojnë panik.
- Unë nuk kam hezitim që të deklaroj, në media, prokurori, gjykatë, kudo, se, me vetëdije të plotë dhe me gjithë fuqinë time intelektuale dhe shpirtërore, do të nxis urrejtjen më të thellë, armiqësinë më të skajshme, ndaj bartësve të një feje, e cila e bën megalehjen teknologjike arabisht, vlerën supreme të saj. Unë nuk kam hezitim që të kërkoj deislamizimin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve, ndalimin e Islamit me ligj, si feja e identifikuar me këtë megalehje teknologjike arabisht. Unë do ta kërkoja deislamizimin e shqiptarëve dhe ndalimin me ligj të fesë islame, edhe nëse do të ndalohej me ligj kjo megalehje teknologjike arabisht, se unë e di që ata të cilët e organizojnë, e kryejnë dhe e adhurojnë këtë megalehje teknologjike arabisht, do të vuanin mungesën e saj dhe do të bënin gjithçka që ta rikthenin atë.
- Është e njohur shprehja se "Qeni që leh nuk kafshon". Por

megalehja teknologjike arabisht paralajmëron një kafshim të tmerrshëm për Shqipërinë dhe krejt kombin shqiptar. Megalehja teknologjike arabisht tregon se Islami shqiptar është bërë një qen i tërbuar dhe qentë e tërbuar asgjësohen. Megalehja teknologjike arabisht pesë herë ditën, ka një të mirë se na kujton rrezikun pesë herë ditën e natën. Unë këtë rrezik e kam paralajmëruar dhe do ta paralajmëroj .

- Prandaj ta harrojë çdo prokuror, gjykatës, se unë do t' i nënshtrohem një hetimi, apo gjykimi të inciuar nga kryeshefi i megalehjes teknologjike arabisht në Shqipëri, haxhi doktor Selim Muça. Derisa Prokurorja e Përgjithshme, Ina Rama, e ka zyrën të rrethuar nga 10-15 megafonë të tre minareve, të cilët gjenden në një distancë të afërt, të cilët përhapin me forcë megalehjen teknologjike arabisht, është qesharake që të merret në konsideratë çdo vendim i Prokurorisë të drejtuar prej saj.

Pas artikullit të mësipërm Kastriot Myftaraj, tek e njëjta e përditshme, më datën 05/06/2010 ka bërë një tjetër shkrim me titullin “Shqipëria Natyrale e mikut tim Koço Danaj, ose ulu Muhamet të bëjmë muhabet” (fq. 15). Ku ndër të tjera thuhet:

- Rindërtimi i dimensionit kulturor të Shqipërisë Natyrale është një proces i vështirë dhe që kërkon kohë. Por ajo që është immediate, duhet që të zhbëhet dëmtimi që u bë në dimensionin kulturor të Shqipërisë Natyrale, në Shpirtin shqiptar. Kjo mund të bëhet lehtë dhe thjesht me deislamizimin e trojeve shqiptare në dy anët e kufirit. Me deislamizim kam parasysh mbylljen e xhamive dhe ndalimin e Islamit në hapësirën shqiptare, me anë të një referendumi nacional.
- Prandaj është e nevojshme që shumësia joislamike e nacionit shqiptar të ndërmarrë një luftë preventive kundër minorancës që i ka dhënë hapësirës shqiptare profil islamik arab, me qëllim deislamizimin e krejt hapësirës shqiptare. Natyrisht që islamikët do t' i rezistojnë deislamizimit. Prandaj ky proces duhet zhvilluar sipas modelit të Izraelit, saktësisht ashtu siç vepron Izraeli në Gaza,

Bregun Perëndimor dhe Liban kundër radikalëve islamikë. Në këtë betejë shqiptarët joislamikë kanë “izraelitët”, ndërsa muslimanët praktikantë arabofilë janë “palestinezët”. Dilema nacionale shqiptare është: A do ta bëjë Shqipëria dhe Kosova luftën preventive ndaj Islamit shqiptar, apo do të presin sa të vijë lufta e ashtuquajtur preventive e fqinjëve kundër nacionit shqiptar, e cila në fakt do të jetë spastrim etnik. Ose Shqipëria dhe Kosova do ta ndalojnë Islamin, duke i mbyllur xhamitë dhe ndaluar ushtrimin e riteve islamike, ose Islami shqiptar do të bëhet ekspedienti i fqinjëve për asgjësimin e nacionit shqiptar. Çështja është: Ose do të vdesin 20, 30 mijë islamikë radikalë në Shqipëri dhe Kosovë, ose do të vdesin 1-2 milion shqiptarë dhe 2-3 milion të tjerë do të dëbohen, jo në Europë, ku nuk do të pranohen, por në vendet islamike. Edhe sikur të arrihet deri tek krijimi i Shqipërisë Natyrale si bashkim shtetëror, është shumë i nevojshëm zhvillimi me ngut i luftës preventive. Kjo luftë duhet bërë sipas mënyrës si e zhvillon Izraeli luftën në Gaza, Bregun Perëndimor dhe Liban. Bastionet islamike sidomos në pjesën shqiptare të Maqedonisë duhen msyrë si qytet e Gazës, ashtu që të thyhet vullneti i radikalëve islamikë dhe të detyrohen pjesa më e madhe e tyre që të largohen për në vendet islamike.

Shqipëria Natyrale, ka nevojë për një terapi shoku që të mbijetojë. Kjo duhet të jetë një terapi izraelite. Në këtë luftë preventive do të dalin heronjtë e rinj nacionalë, të ngjashëm me Ariel Sharon, Ehud Olmert, Zibi Livni, Benjamin Netanjahu, Moshe Dajan etj. Këta do të jenë heronjtë e Shqipërisë Natyrale.

II. Aktet ligjore të zbatueshme

1. Kushtetuta

5. **“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose vlera të tjera universale (...) vendosim këtë Kushtetutë”.** (Preambula)

2. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

6. “(...) bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shtetit, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe ti mbrojë.” (Neni 3)
7. “1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. 2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë. 3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.” (Neni 4)
8. “1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. 2. Shteti është asnjëherë në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. 3. Shteti njeh barazinë e bashkësive fetare. 4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjellë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. 5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend. 6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.” (Neni 10)
9. “1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. 2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t’i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve. 3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.” (Neni 24)
10. “Çështjet që lidhen me (...) kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut (...) nuk mund të shtrohen në asnjë referendum” (Neni 151/2)
11. “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si dhe lirinë për të shfaqur fenë e tij ose bindjet e tij individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë së tij ose e bindjeve të tij nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shëndetit ose të moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.” (Neni 9 - Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë)
12. “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të vendosin regjim autorizimesh për sipërmarrjet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit. 2. Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji dhe që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masa të nevojshme për sigurimin kombëtar, integritetin territorial ose sigurinë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.” (Neni 10 - Liria e shprehjes)
13. “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.” (Neni 13 - E drejta për ankim efektiv)
14. “Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i

jep një Shteti, grupimi ose individi, të drejtë që të ndërmarrë ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave ose lirive të njohura në këtë Konventë, ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive të parashikuara gjithashtu në këtë Konventë.” (Neni 17 - Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës)

3. Kodi i Procedurës Penale

15. “1. Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.” (Neni 2 - Respektimi i normave procedurale)

16. “1. Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod.(...)” (Neni 24/1 - Funkcionet e prokurorit)

17. “1. Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.” (Neni 280 - Marrja dijeni për veprën penale)

18. “1. Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm. 2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit. 3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 195.” (Neni 283 - Kallëzimi nga ana e shtetasve)

4. Kodi Penal

19. “Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.”. (Neni 25 - Kuptimi i bashkëpunimit)

20. “Rëndojnë dënimin rrethanat që vijojnë: a) Kryerja e veprës i shtyrë nga motive të dobëta; b) kryerja e veprës (...) për të siguruar për vete a për të tretët fitime pasurore, ose çdo lloj përfitimi tjetër material; ç) kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë; gj) kryerja e veprës penale në bashkëpunim; h) kryerja e veprës penale më shumë se një herë;”. (Neni 50 – Rrethanat rënduese)

21. “Ndalimi i veprimtarive të organizatave fetare, si dhe krijimi i pengesave për ushtrimin e lirë të veprimtarive të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”. (Neni 131 - Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare)

22. “Shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i objekteve të kultit, kur ka shkaktuar humbjen plotësisht ose pjesërisht të vlerave të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”. (Neni 132 - Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit)

23. “Ndalimi ose krijimi i pengesave që u bëhen personave për të marrë pjesë në ceremonitë fetare, si dhe për të shprehur lirisht bindjet fetare, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.”. (Neni 133 - Pengimi i ceremonive fetare)

24. “Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve raciale, nacionale ose fetare, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja me qëllim përhapjeje e shkrimeve me përmbajtje të tillë, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.”. (Neni 265 - Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve)

5. “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ratifikuar me Ligjin Nr. 10 056, datë 22.1.2009.

25. “Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është: a) të garantojë realizimin e të

drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë; b) të njohë e të garantojë respektimin e të drejtave të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, të statutit dhe traditave të tij, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e besimtarëve, respektimin e riteve dhe praktikave tradicionale, të institucioneve dhe strukturave të tij, si dhe personave juridikë të themeluar prej tij, për të zhvilluar lirisht misionin e tyre fetar, edukativ e bamirës; c) të njohë dhe të garantojë paprekshmërinë e institucioneve myslimane të kultit, për aq sa veprimtaria e tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, me Kushtetutën e ligjet në fuqi, si dhe traditën dhe statutin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë; d) të garantojë lirinë e individit për të ushtruar fenë islame, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare myslimane, ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve përkatëse fetare; e) të sigurojë lirinë e individit për të mos u ndaluar dhe as detyruar të bëjë pjesë në bashkësinë fetare myslimane, për të marrë pjesë në praktikat, ritet dhe në strukturat drejtuese të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.” (Neni 3)

III. Analiza

26. Nëse do të analizojmë përmbajtjen e secilit prej këtyre shkrimeve, nga fillimi deri në fundin e tyre, vërehet qartazi një gjuhë abuzive me lirinë e shprehjes, duke cënuar rëndë rendin kushtetues shqiptar, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësinë shoqërore, si dhe bashkëjetesën fetare. Të gjithë këto elementë të cënuar, janë konsideruar në mënyrë të drejtpërdrejtë si vetë baza e këtij shteti (nga Preambula dhe Nenet 3, 10, 24 të Kushtetutës), i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.

27. Konkretisht në shkrimin e datës 25.05.2010 të titulluar : « Ylli i kuq i Moskës dhe Guri i zi i Mekës », shtetasi Kastriot Myftaraj shkruan dhe Gazeta « SOT » boton se : “(...) muslimani shqiptar është armiku, me të nuk kam ç'të diskutoj, dhe me të as mund të diskutohet. Ai shfaq një barbari të thellë. Unë e urrej

atë, se ai është bartës i një feje që shfaq hapur armiqësinë ndaj kombit shqiptar(...)”. Këtu vërehet gjuha ekstremiste e përdorur nga autori dhe e shpërndarë nga gazeta, ku besimtarët muslimanë quhen armiq dhe nxitet urrejtja dhe barbaria ndaj tyre. Gjithashtu me anë të këtij artikulli, synohet që kjo kategori e popullsisë të vendoset përballë pjesës tjetër të kombit shqiptar, në një armiqësi të thellë.

28. Akoma më tej në të njëjtin shkrim promovohet se : “(...) Islami është armik i kombit shqiptar dhe bota islame e urren kombin shqiptar(...)”. Edhe kjo fjali e përdorur është tërësisht ekstremiste, duke nxitur armiqësi të dyanshme. Nga njëra anë muslimanët dhe feja islame konsiderohen si armiq të kombit shqiptar, dhe nga ana tjetër, vendos botën islame (afërsisht ¼ e popullsisë së globit) në armiqësi me kombin shqiptar.

29. Pasi shfaqet urrejtja ndaj muslimanëve dhe fesë islame, e cila sot është zyrtarisht e njohur nga institucionet ndërkombëtare dhe kombëtare si feja e cila përbën shumicën e popullsisë shqiptare, shtetasi Kastriot Myftaraj dhe Gazeta “SOT” shkojnë akoma më thellë në ekstremizmin e tyre. Ata sugjerojnë dhunë, urrejtjeje publike dhe shkatërrim ndaj fesë islame dhe muslimanëve, madje deri në çbërjen e çdo shenje të kësaj feje. Në këtë artikull thuhet se : “(...) Sot deislamizimi është sfida historike për shqiptarët, në dy anët e kufirit. Në trojet shqiptare duhet të zhbëhet çdo shenjë e Islamit (...)”.

30. Madje sugjerimi i tij publik shkon deri në ekstrem. Përveç thirrjes për cenimin e rendit kushtetues dhe sigurisë publike duke ç'rrenjosur çdo shenjë të fesë islame në trojet shqiptare, shtetasi Kastriot Myftaraj shkruan se duhet të ndërmerren edhe akte të tjera antikushtetuese ndaj kësaj feje. Konkretisht ai sugjeron që kundër këtij besimi fetar në Republikën e Shqipërisë të mbahet një referendum antikushtetues. Pavarësisht se populli shqiptar në Kushtetutën aktuale ka mbajtur qëndrimin e qartë dhe të prerë se : “Çështjet që lidhen me (...) kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut (...) nuk mund të shtrohen në asnjë referendum” (Neni 151/2), përsëri ky shtetas sugjeron veprime antikushtetuese. Pikërisht në këtë shkrim vazhdon thirrjet e tij antikushtetuese duke sugjeruar dhe nxitur se : “(...) Ne shqiptarët duhet të ndahemi me Islamin me anë të një

referendumi mbarëkombëtar, ku njerëzit duhet të pyeten për ndalimin e tij. Ky referendum duhet të bëhet me votim të hapur, si një rast i veçantë (...).

31. Madje në mënyrë haptazi antikushtetuese, duke cenuar dinjitetin njerëzor si dhe liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, sidomos lirinë e besimit fetar, shkrimi publik i këtij shtetasi shkon në një tjetër pikë absurde dhe nxitëse të dhunimit të rendit kushtetues në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht ky shtetas shkruan në mënyrë publike se: **“(...) Çdo njeriu që do të deklarohet si musliman duhet t’i hiqet shtetësia e Republikës së Shqipërisë, eventualisht e Kosovës dhe të marrë statusin e emigrantit, duke u quajtur emigrant arab. Derisa në Shqipëri dhe Kosovë ka një komunitet të sajuar egjiptian, le të ketë dhe një komunitet emigrantësh arabë. (...)”**.

32. Nxitjet për urrejtje, destabilizim dhe dhunë publike, në këtë shkrim përveçse në nivel fetar, i drejtohen edhe ndaj bashkësive etnike shqiptare që gjenden jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ndaj tyre në këtë shkrim mbahet qëndrimi se: **“(...) Nëse (referendumi) fiton në pjesën shqiptare të Maqedonisë atëherë këta njerëz le të shkojnë në dreq, le të shkojnë tek guri i zi i Mekës, se nuk kanë çka i duhen kombit shqiptar. Për mua ata është njëllor sikur të jenë në Arabi (...)”**.

33. Shtetasi Kastriot Myftaraj dhe Gazeta “SOT” me anë të këtij shkrimi haptazi antikushtetues, duke abuzuar në mënyrë flagrante me lirinë e shprehjes, ka vazhduar të cenojnë rëndë rendin kushtetues shqiptar, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësinë shoqërore, si dhe bashkëjetesën fetare, akoma më tej. Të dy këto subjekte synojnë të godasin një nga fetë më të mëdha dhe më të mirënjohura monoteiste në nivel global, etnik dhe brenda Republikës së Shqipërisë, duke nxitur dhunë dhe urrejtje shoqërore ndaj fesë islame në shkrimin e tyre. Në këtë shkrim ata vazhdojnë të mbajë të njëjtin qëndrim antikushtetues, denigrues dhe kriminal se: **“(...) Shqiptarët mund të besojnë tek Zoti pa pasur nevojë për këtë surrogat-fe të shkretëtirave, çka është Islami. Islami shqiptarëve nuk u ka sjellë veçse të këqija, dhe të këqija më të mëdha do t’u sjellë edhe në të ardhmen. Islami nuk i lidh shqiptarët me Zotin, por me idhujtari antike**

të shkretëtirave. (...) Ylli i kuq dhe Guri i zi takohen si simbole të së keqes. Ne nuk mund të lejojmë që fati i kombit shqiptar të rrijë edhe më tej i ndryrë si në një magji të zezë tek Guri i zi në Mekë (...)”.

34. Thirrjet antikushtetuese që vënë në rrezik rendin kushtetues, sigurinë publike, të drejtat dhe liritë themelore të individëve si dhe bashkëjetesën fetare si një nga vlerat më të spikatura të kombit shqiptar në shekuj, shkojnë dhe kulmojnë akoma të tej në përfundim të këtij shkrimi. Ai nxit haptazi urrejtjen ndaj fesë islame, ndaj muslimanëve, apo ndaj shqiptarëve të FYROM (Maqedonisë) apo Kosovës, duke synuar grindje apo luftë fetare në këto republika, dhe sidomos në Republikën e Shqipërisë. Këtë nxitje, autori i këtij shkrimi dhe gazeta botuese e bëjnë haptazi kur në përmbajtje të tij bëhet kushtrimi ekstremist-terrorist se: **“(...) Islami i ka shpallur luftë kombit shqiptar, duke synuar që ta mbajë të ndarë nga Perëndimi. Në këtë luftë xhamitë janë fortesat e ushtrisë armike, minaret janë tytat e topave të ushtrisë armike, islamikët praktikantë janë ushtarët armiq(...)”**.

35. Por veprimtaria antikushtetuese dhe ekstremiste e shtetasit Kastriot Myftaraj në bashkëpunim me Gazetën “SOT” në lidhje me çështjen në fjalë, nuk filloi dhe as nuk përfundoi me këtë shkrim.

36. Pikërisht në datën 28 Maj 2010, i njëjti autor, me anë të së njëjtës gazetë të përditshme shkruan dhe boton një tjetër shkrim të titulluar: **“Një formulë për matjen e shkallës së rrezikut të terrorizmit islamik në Shqipëri dhe Kosovë”**. Në vazhdim të shkrimit të mëparshëm, që nga titulli vërehet se nga ky shtetas dhe kjo gazetë është dhënë edhe formula se si mund të veprohet ndaj fesë islame dhe muslimanëve në territoret etnike shqiptare dhe në Republikën e Shqipërisë. Ata në artikullin e dytë të tyre, gjatë gjithë përmbajtjes së tij, por akoma më qartë në përfundim sugjerojnë që: **“(...) Shkurt është e nevojshme një luftë preventive kundër radikalizmit islamik në Shqipëri, një luftë e ngjashme me ato që zhvillon Izraeli në Gaza, Bregun Perëndimor dhe Liban. Mënyra më efikase për zhvillimin e kësaj lufte është nxjerrja jashtë ligjit e fesë islame në Shqipëri dhe mbyllja e të gjitha objekteve të saj të kultit. Bashkësia Islame e Shqipërisë, siç quhet tash Komuniteti**

Musliman, mund të thotë se nuk është fajtorë për atë se ka radikalë islamikë në Shqipëri, por është ekzistenca e fesë islame dhe e objekteve të saj të kultit në Shqipëri, që ka siguruar logjikën e radikalizmit islamik në Shqipëri. Pra, jo të gjithë muslimanët shqiptarë (me muslimanë këtu kuptoj praktikanët) janë terroristë potencialë, por të gjithë terroristët nesër do të jenë muslimanë(...)”.

37. Por situata u bë edhe më e rëndë, kur Komuniteti Musliman Shqiptar ndoqi rrugët ligjore, dhe jo veprimet e dhunës që pritëshin nga dy subjektet kriminale të mësipërme. Konkretisht KMSH depozitoi ndaj shkruarit të këtyre dy artikujve një kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në dhunim të çdo norme kushtetuese dhe ligjore, shtetasi Kastriot Myftaraj dhe Gazeta « SOT», kanë shkuar edhe më tej në dhunën e tyre. Ata kanë botuar një tjetër artikull që është me ekstremist se çdo ekstrem i menduar ndonjëherë jo vetëm në Republikën e Shqipërisë, por jo vetëm. Konkretisht në datën 02.06.2010 është botuar shkrimi me titull : «**Kur lehja e qenit ndaj hënës quhet fe**».

38. Në fakt ky artikull nuk vlen të analizohet sepse përmbajtja e tij në çdo rresht është krim i hapur kundër rendit kushtetues shqiptar, dinjitetit të njeriut, të drejtave dhe lirive themelore të tij, drejtësisë shoqërore, si dhe bashkëjetesës fetare. Prandaj preferojmë që thjesht të bashkëngjisim përmbajtjen kriminale dhe ekstremiste të këtij artikulli.

39. Siç vërehet nga ky artikull, por edhe nga ata pararendës, shtetasi Kastriot Myftaraj duke abuzuar me lirinë e shprehjes me anë të artikujve në media, në bashkëpunim me Gazetën “SOT”, kanë përhapur në mënyrë të përsëritur shkrime që nxisin urrejtjen ndaj fesë islame dhe popullsisë muslimane. Po ashtu këto shkrime nxisin haptazi edhe grindje fetare në Republikën e Shqipërisë dhe territoret etnike shqiptare, duke vënë në rrezik individët që i përkasin fesë islame dhe deklarohen si muslimanë.

40. Akoma më tej, të tilla shkrime që bëjnë thirrje për urrejtje kundër kësaj pjese të popullsisë, duke i fyer dhe shpifur për to, si dhe duke kërkuar përdorimin e dhunës apo të veprimeve të tjera arbitrare ndaj tyre (si

mbajtja e referendumeve antikushtetuese dhe lufta preventive), cenojnë rëndë rendin kushtetues shqiptar, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësinë shoqërore, si dhe bashkëjetesën fetare. Të gjithë këto elementë të cenuar, janë konsideruar në mënyrë të drejtpërdrejtë si vetë baza e këtij shteti (Preambula dhe Neni 3 i Kushtetutës), i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.

E nderuar Prokurore e Përgjithshme znj. Ina Rama!

Të nderuar prokurorë të Rrethit Gjyqësor Tiranë!

41. Një nga vlerat më të mëdha njerëzore që lidhet drejtpërsëdrejti me botën e tij të brendshme, është liria e ndërgjegjes dhe fesë. Sot kjo liri themelore, konsiderohet si e liria më e rëndësishme e korpusit të brendshëm njerëzor, dhe shprehet zakonisht nën titullin: **”liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë”**. Në këto titull e garantojnë këtë të drejtë pothuaj të gjitha aktet ndërkombëtare, por edhe ato të brendshme, kushtetuese apo ligjore.

42. Pikërisht për të njohur dhe mbrojtur këto vlera, shoqëritë moderne njerëzore janë kujdesur posaçërisht për garantimin e lirisë së ndërgjegjes dhe besimit fetar, si një nga të drejtat më themelore humane. Ja se si është formuluar kjo liri në dy nga aktet më të rëndësishme të komunitetit ndërkombëtar; **”Deklaratën Universale të të drejtave të Njeriut” (DUDNJ)** dhe **”Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut” (KEDNJ)**: **”Çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë. Kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si dhe lirinë për të shfaqur fenë e tij ose bindjet e tij, individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve.”**

43. Siç sanksionohet në Nenin 18 të DUDNJ dhe në Nenin 9 të KEDNJ, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, është një ndër themelet e shoqërive demokratike sipas kuptimit të akteve ndërkombëtare. Në dimensionin e saj fetar, kjo e drejtë është një ndër elementet më jetikë që përbën identitetin e besimtarëve dhe

konceptimin e vetë jetës nga ana e tyre. Por nga ana tjetër, kjo liri, në mënyre të padiskutueshme është dhe një pasuri e çmuar për ateistët, agnostikët, skeptikët dhe të paimteruarit. Garantimi i kësaj të drejte është faktor shumë i rëndësishëm i bashkëjetesës fetare, i bashkëjetesës së përgjithshme në diversitet, dhe i zhvillimit të pluralizmit të mendimeve në një shoqëri demokratike. Prandaj, kjo liri gjendet e gdhendur edhe në pothuaj gjithë Kushtetutat (aktet themelore) të çdo shteti.

44. Si rrallë në ndonjë kushtetutë tjetër më parë, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vitit 1998 është treguar një kujdes i posaçëm për të sanksionuar e garantuar lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë. Hartuesit e Kushtetutës kanë dashur ta bëjnë plotësisht të besueshme shkëputjen e saj nga përvoja e mëparshme e shtetit komunist, duke sanksionuar vlera të reja që realizojnë e garantojnë lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë në mjaft nene të saj. Dhe natyrisht, këto vlera u përqaftuan edhe nga populli shqiptar me anë të referendumit pranues që iu bë në 21 Nëntor 1998, Kushtetutë që është ende në fuqi.

45. Që në preambulën e saj, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë hapet me deklarin: **“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose vlera të tjera universale (...) vendosim këtë Kushtetutë”**. Nga kjo mënyrë formulimi, duket që në fillim kujdesi dhe mbështetja e veçantë që bën Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në lidhje me besimin fetar apo bindjet e tjera.

Bashkëjetesa fetare

46. Në preambulën e Kushtetutës së R.Sh., përmendet një vlerë tjetër që lidhet drejtpërdrejt me lirinë e besimit fetar, që është “bashkëjetesa fetare”. Kjo e fundit madje konsiderohet si një nga vlerat më të rëndësishme të shoqërisë shqiptare, e konfirmuar qartësisht edhe nga ndërkombëtarët në raportet e tyre për Shqipërinë.

47. Kur analizon tërë mozaikun e besimeve në Shqipëri, (4 bashkësi tradicionale plus dhjetëra besime të hyra rishtazi), e kupton vërtet se cila është vlera e vërtetë e bashkëjetesës fetare. Mu për këtë, “bashkëjetesa fetare” konsiderohet aq e

rëndësishme nga populli shqiptar, aq sa ajo gjendet e “gdhendur” që në preambul, përkrah disa vlerave të tjera të mëdha të shoqërive demokratike, si; pluralizmi, rendi kushtetues, shteti i së drejtës, etj. Sipas preambulës së Kushtetutës së R.Sh.; **“Ne, populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale (...) me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare (...) vendosim këtë Kushtetutë.”**

48. Përveçse në preambul, “bashkëjetesa fetare” gjendet përsëri edhe në Nenin 3 të Kushtetutës së R.SH. Risjellja e “bashkëjetesës fetare” edhe në këtë dispozitë normative kushtetuese, e bën lehtësisht të kuptueshme rëndësinë e veçantë të saj, mjafton të përmendim faktin se; në Nenin 3 sanksionohen bazat e shtetit shqiptar.

49. Më konkretisht, Nenin 3 garanton se; **“(…) bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shtetit, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.”**

50. Nga përcaktimet e mësipërme kushtetuese lidhur me “bashkëjetesën fetare” rrjedh qartë rëndësia e trajtimit të kësaj çështjeje, qoftë si vlerë sociale, qoftë si koncept kushtetues apo si një nga bazat e shtetit. Prandaj trajtimi, ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i “bashkëjetesës fetare” në shoqërinë shqiptare, lypset që të bëhet me maturi, përderisa përbën (sipas Kushtetutës), një nga bazat e shtetit shqiptar. **Maturia duhet të shfaqet nga njëra anë, si nga individët privatë, shoqëria civile, media, ashtu edhe bashkësitë e ndryshme fetare, por sidomos në mënyrë të padiskutueshme, maturia në trajtimin e kësaj çështjeje duhet të shfaqet nga shteti dhe institucionet e tij. Është ky i fundit (shteti) i cili, në rast se ndonjëri prej aktorëve të mësipërm si: individët privatë, shoqëria civile, media; do të cenonin këtë vlerë të rëndësishme kushtetuese, duhet të ndërhyjë për ta ruajtur të paprekur.**

Liria e ndërgjegjes dhe e fesë

51. Liria e ndërgjegjes dhe fesë është një nga liritë dhe të drejtat më themelore të qenieve

njerëzore. Ajo gjendet e garantuar shprehimisht në Nenin 24 të Kushtetutës dhe përbën një nga nenet më të rëndësishme Kartave Ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si dhe të Kushtetutës aktuale shqiptare. Përgjithësisht, ky nen mbron në radhë të parë, sferën e bindjeve personale dhe fetare të individit, ose atë që shpesh nga doktrina dhe jurisprudenca konsiderohet si “forum i brendshëm” i qenieve njerëzore.

52. Konkretisht, përmbajtja e kësaj lirie themelore shprehet në Nenin 24 të Kushtetutës në këtë mënyrë: **“1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. 2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t’i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve. 3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohe të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.”**

53. Kushtetuta e R.Sh. në përmbajtjen e Nenit 24, është kujdesur që përveç garantimit në mënyrë deklarative të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, që bëhet në paragrafin e parë, dhe garantimit të thelbit të kësaj lirie që bëhet në paragrafin e dytë, të shkojë edhe më tej. Sipas Nenit 24/3, specifikohet prerazi se: **“Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohe të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.”**

54. Nga një lexim i shpejtë dhe vështirë *prima facie* i këtij paragrafi, vërehet se ai është paragrafi me gjuhën më imperative dhe më të drejtpërdrejtë të gjithë Nenit 24, pa lënë asnjë vend për dykuptimësi apo përjashtime. Madje kjo dispozitë kushtetuese duket qartë se mund të aplikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa pasur nevojë për akte të tjera normative. Përmbajtja e saj është mjaftueshëm e hollësishme dhe e qartë. Në Republikën e Shqipërisë: **Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohe të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.**

55. Kjo normë kushtetuese dhe fuqia e saj, bëhet më e qartë nëse do të rikujtojmë se sipas Nenit 4/2 të Kushtetutës: **“Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.”** Madje garancia kushtetuese e mësipërme, se: **“Askush nuk mund**

të detyrohet ose të ndalohe të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij”, është nga më të drejtpërdrejtat dhe më imperative. Si e tillë, ajo mund të aplikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse; **“Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.”(Neni 4/3).**

56. Por le të analizojmë disi më thellë paragrafin e tretë të Nenin 24. Populli shqiptar, duke qenë nga popujt unikë në botë me praktikën më të hidhur dhunuese ndaj lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, është kujdesur që këtë liri themelore ta sigurojë në mënyrën më të mirë të mundshme. Kështu, pavarësisht garancive kushtetuese që burojnë nga paragrafi i parë dhe i dytë i Nenit 24, është shkuar edhe më tej me paragrafin e tretë. Sipas këtij paragrafi: **“Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohe të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij”**.

57. Nga sa më sipër, vërejmë se burojnë dy lloj urdhërimesh kushtetuese. Njëra, synon të pengojë çfarëdolloj detyrimi, dhe tjetra, synon të pengojë çfarëdolloj ndalimi, nga e drejta e shfaqjes së lirisë së ndërgjegjes dhe fesë me anë të pjesëmarrjes në një bashkësi fetare apo në praktikat e saj, si dhe në bërjen publike të bindjeve apo besimit. Më konkretisht:

I. Askush nuk mund të detyrohet:

- Të marrë pjesë në një bashkësi fetare;
- Të marrë pjesë në praktikat e një bashkësie fetare;
- Të bëjë publike bindjet e tij fetare/jofetare;
- Të bëjë publike besimin e tij.

II. Askush nuk mund të ndalohe:

- Të marrë pjesë në një bashkësi fetare;
- Të marrë pjesë në praktikat e një bashkësi fetare;
- Të bëjë publike bindjet e tij fetare/jofetare;
- Të bëjë publike besimin e tij.

58. Siç vërehet, grupi i parë i urdhërimeve kushtetuese të mësipërme, synon që t’i garantojë kujtdo, lirinë për të mos u detyruar të marrë pjesë në një bashkësi fetare, apo në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet apo besimin

- e tij. Kjo garanci është e rëndësishme, pasi i siguron individit lirinë e plotë të ndërgjegjes dhe besimit fetar/jofetar, sidomos sa i përket lirisë së pasjes, mospasjes apo ndryshimit të fesë.
59. Gjithashtu, kjo garanci kushtetuese i siguron individëve të drejtën e jetës private (privacy), duke mos detyruar të publikojnë bindjet ose besimin e tyre. Vlen të theksohet se; Nga **liria për të mos u detyruar të marrë pjesë në një bashkësi fetare, apo në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet apo besimin e tij**, nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë përjashtim. Kjo do të thotë që këtë garanci kushtetuese e kanë pa përjashtim si individët e thjeshtë ashtu edhe personat publikë.
60. Grupi i dytë i urdhërimeve kushtetuese të mësipërme, synon që t'i garantojë kujtdo, **lirinë për të mos u ndaluar të marrë pjesë në një bashkësi fetare, apo në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet apo besimin e tij**. Edhe kjo garanci kushtetuese është e rëndësishme, pasi i siguron individit lirinë e plotë të ndërgjegjes dhe besimit fetar/jofetar, sidomos sa i përket lirisë së pasjes, mospasjes apo ndryshimit të fesë.
61. Gjithashtu, kjo garanci kushtetuese i siguron individëve të drejtën e jetës private (privacy), duke mos i ndaluar të publikojnë bindjet ose besimin e tyre. Vlen edhe këtu të theksohet se; Nga **liria për të mos u ndaluar të marrë pjesë në një bashkësi fetare, apo në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet apo besimin e tij**, nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë përjashtim. Kjo do të thotë që këtë garanci kushtetuese e kanë pa përjashtim si individët e thjeshtë ashtu edhe personat publikë, duke përfshirë deri Presidentin i Republikës.
62. Në pamje të parë duket sikur për hir të parimit të "shtetit laik", mund të kishte përjashtime nga garancitë kushtetuese të mësipërme, sa i përket personave që kryejnë funksione të rëndësishme publike. Kjo pasi mund të dukej sikur shteti, me anë të veprimeve të këtyre funksionarëve publikë, ishte duke mbajtur njërin apo tjetrën linjë fetare, ndërkohë që duhet të ishte i barazlanguar prej tyre.
63. Por nëse do të hyjmë në thellësi të garancisë kushtetuese, se; **"Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij"**, do të vërejmë se nga ky rregull nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë përjashtim. Këtë e themi jo vetëm nga kuptimi etimologjik dhe terminologjik i fjalës; **"Askush(...)"** në mënyrë të shkëputur, por edhe më gjerë se kaq. Përveçse nga interpretimi literal dhe strikt i dispozitës kushtetuese të mësipërme, edhe nga interpretimi teleologjik dhe i zgjeruar, mbërrijmë në të njëjtin përfundim. Nga rregulli kushtetues i mësipërm, nuk ka dhe nuk mund të ketë përjashtime.
64. Disa nga shkaqet e këtij konkluzioni, i parashtruam hollësisht më sipër, por ajo që mund të shtojmë këtu është fakti që; sipas Kushtetutës, më e rëndësishme se sa frika nga cenim në dukje i "shtetit laik", është garantimi i lirisë themelore të ndërgjegjes dhe fesë të çdo individi, përfshirë këtu edhe ata me funksione të larta publike. Funksionarët publikë, përpara se të jenë presidentë, deputetë, ministra, gjyqtarë apo funksionarë të tjerë të lartë shtetërorë, janë njerëz, të cilët kanë të drejta dhe nevoja humane, të cilat duhet të përmbushen me prioritet. Aq më tepër kur bëhet fjalë për ato të drejta dhe liri që janë klasifikuar si themelore jo vetëm nga Kushtetuta aktuale por edhe nga shumica e akteve ndërkombëtare.
65. Kjo tezë konfirmohet edhe nga vetë përmbajtja e Nenit 88/3 të Kushtetutës, sipas të cilit: **"Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i Presidentit që largohet. Presidenti bën këtë betim: "Betohej se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t'i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar."** Presidenti mund të shtojë edhe: **"Zoti më ndihmoftë!"**.
66. Një tjetër argument se pse nuk mund të ketë përjashtime nga garancia kushtetuese e Nenit 24/3 është edhe vetë "shtet laik". Sipas parimeve të vendosura nga Neni 10 i Kushtetutës, "shtet laik" është jo vetëm ai që është i ndarë nga feja, dhe është asnjëherë në çështjet e besimit, por edhe shteti i cili "(...)garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike.". Pa

respektimin in block (në bllok) të gjithë parimeve përbërës të "shtetit laik", vetë ai do të ishte i mangët, dhe mbi të gjitha, veprimtaria e tij nuk do të ishte në përputhje me Kushtetutën.

67. Kështu, prokuroria si organ kushtetues që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit (neni 148 i Kushtetutës), në rastin konkret duhet të ndërhyje në mënyrë të menjëhershme për të ruajtur këto vlera kushtetuese, të cilat siç do të analizohen më poshtë, janë konsideruar edhe si krime nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

68. Siç u analizua më sipër, shtetasi Kastriot Myftaraj duke abuzuar me lirinë e shprehjes me anë të artikujve në media, në bashkëpunim me Gazetën "SOT" ka përhapur në mënyrë të përsëritur shkrime që nxisin urrejtjen ndaj një feje të caktuar, konkretisht fesë islame dhe muslimanëve. Po ashtu këto shkrime nxisin haptazi edhe grindje fetare në Republikën e Shqipërisë dhe territoret etnike shqiptare, duke vënë në rrezik liritë dhe të drejtat themelore të individëve që i përkasin fesë islame dhe deklarohen si muslimanë.

69. Akoma më tej, të tilla shkrime që bëjnë thirrje për urrejtje kundër kësaj pjese të popullsisë, duke i fyer dhe shpifur për to, si dhe duke kërkuar përdorimin e dhunës apo të veprimeve të tjera arbitrare ndaj tyre (si mbajtja e referendumeve antikushtetuese), cenojnë rëndë rendin kushtetues shqiptar, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësinë shoqërore, si dhe bashkëjetesën fetare. Të gjithë këto elementë të cenuar, janë konsideruar në mënyrë të drejtpërdrejtë si vetë baza e këtij shteti (Preambula, Neni 3, 10 dhe 24 të Kushtetutës), i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.

Aktet ndërkombëtare

70. Raporti ndërmjet shtetit shqiptar dhe fesë, përveçse nga Kushtetuta e 1998-ës është normuar edhe nga aktet ndërkombëtare me fuqi juridike në Shqipëri. Madje këto akte, sipas Kushtetutës, zënë një vend të rëndësishëm në piramidën e akteve normative në Shqipëri. Sipas Nenit 116: **"Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta;**

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; (...)". Ndërsa sipas Nenit 122: **"(...) Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, (...)"**.

71. Natyrisht që nga të gjitha akteve ndërkombëtare me fuqi juridike në Shqipëri, një nga më të rëndësishmit është padyshim, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

72. Përveç saj, në ditët e sotme, instrumentet ose aktet kryesore juridike ndërkombëtare globale apo rajonale, në të cilat janë projektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, konkretisht edhe liria e ndërgjegjes dhe fesë, dhe që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, janë:

- **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) (Neni 18);**
- **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966)(Neni 18);**
- **Deklarata e OKB e 1981 "Mbi heqjen e të gjitha formave të intolerancës dhe të parabazisë mbi bazën e fesë apo besimit";**
- **Konventa e të Drejtave të Fëmijës (1989) (Neni 14);**
- **Akti Përfundimtar i Helsinkit i 1975 dhe norma të ndryshme shtesë të miratuara nën kujdesin e OSBE-së;**

73. Të gjitha aktet e mësipërme ndërkombëtare globale apo rajonale janë pjesë e rendit të brendshëm juridik shqiptar, që kanë për qëllim të garantojnë lirinë e ndërgjegjes dhe fesë. Por akti ndërkombëtar më i rëndësishëm rajonal në kuadër të Këshillit të Evropës dhe me efekte juridike të drejtpërdrejta lidhur me garantimin e kësaj lirie, është pa dyshim Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

KEDNJ

74. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e hartuar në Romë në 4 Nëntor 1950 (ka hyrë në fuqi më 8 Shtator 1953), është një kartë e vërtetë kushtetuese e të drejtave dhe lirive themelore politike dhe civile për vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Ky dokument përbën një vlerë të përbashkët

të demokracive evropiane. Falë KEDNJ-së, ekziston aktualisht një rend juridik në sferën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, që përfshin jo vetëm katalogun e të drejtave të mbrojtura, por edhe një mekanizëm unikal në shkallë rajonale për realizimin e tyre. KEDNJ është në këtë aspekt, një sipërmarrje origjinale në krahasim me konceptet klasike të së drejtës ndërkombëtare, para së gjithash, si rezultat i kontrollit në nivel mbishtetëror të akteve dhe veprimeve të shtetit, i nisur me iniciativën edhe të vetë të dëmtuarve.

75. Një nga liritë themelore që shtetet palë të KEDNJ-së (përfshirë edhe Shqipërinë që nga viti 1996), duhet të garantojnë është: Liria e Ndërgjegjes dhe Fesë. Kjo liri gjendet e sanksionuar në Nenin 9 të KEDNJ-së, nën këtë përmbajtje: **“Çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si dhe lirinë për të shfaqur fenë e tij ose bindjet e tij, individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve. Liria e shfaqjes së fesë ose e bindjeve nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera, nga ato që, të parashikuara me ligj, përbëjnë masat e nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shëndetit ose të moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.”**

76. Liria e mendimit ndërgjegjes dhe e fesë, e normuar nga Neni 9 i KEDNJ, si një nga të drejtat më themelore të njeriut, përbën gjithashtu edhe një nga nenet më të rëndësishëm të gjithë KEDNJ-së. Në kuptim të KEDNJ, ky nen hedh themelet dhe bazat e një shoqërie demokratike. Ekzistenca e pluralizmit, e lidhur pazgjidhshmërisht me shoqërinë demokratike, dhe i fituar me vështirësi gjatë shekujve, varet nga respektimi i lirive për të cilat bëhet fjalë në Nenin 9 të KEDNJ. Ky nen mbron në radhë të parë, sferën e bindjeve personale dhe fetare të individit, ose atë që shpesh quhet si “forum i brendshëm”.

77. Nga përmbajtja e Nenit 9 të KEDNJ vërehet se liria e shfaqjes së besimit individualisht është garancia e parë që jep Konventa. Kjo shfaqje do të thotë, që çdo person në mënyrë të veçante dhe personalisht, ka të drejtë të shfaqë besimin apo bindjet e tij. Madje KEDNJ shkon me tej duke garantuar se “liria për te

shfaqur fenë ose bindjet” si liri personale, mund të ushtrohet jo vetëm privatisht, por edhe publikisht. Kjo do të thotë që KEDNJ është kujdesur në mënyrë të veçante për ushtrimin e lirisë për të shfaqur fenë apo bindjet, duke e garantuar atë si në planin privat por edhe atë publik. Po ashtu, “liria për të shfaqur fenë ose bindjet” mund të ushtrohet jo vetëm individualisht në planin privat apo publik, por edhe në mënyrë kolektive. Kjo është një garanci shumë e rëndësishme e cila e jep jete zhvillimit të personalitetit të besimtareve si individualisht por edhe kolektivisht. Nga kjo e fundit rrjedh edhe e drejta për të ngritur institucione fetare apo të kultit.

78. Po ashtu, sipas Konventës por edhe sipas jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata e Strasburgut), vërehet se liria për të shfaqur fenë ose bindjet, e ushtruar në mënyrë individuale ose kolektive, privatisht apo publikisht, e garantuar nga Neni 9 i KEDNJ, do të ishte jo e plotë, nëse nuk do të përmbante edhe mjetet e shfaqjes së fesë ose bindjeve. Në këtë Nen parashikohet në mënyrë deklarative se: **“Çdo person ka (...) lirinë për të shfaqur fenë e tij ose bindjet e tij, individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet; kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve.”**

79. Në fakt, siç vërehet nga artikujt e shkruar më sipër, goditen hapur këto vlera të garantuara nga KEDNJ. Konkretisht shtetasi Kastriot Myftaraj në bashkëpunim me Gazetën “SOT” dhunojnë rëndë lirinë themelore për të shfaqur fenë ose bindjet, e ushtruar në mënyrë individuale ose kolektive, privatisht apo publikisht, e garantuar nga Neni 9 i KEDNJ. Ata në shkrimin e tyre synojnë të dhunojnë rëndë këtë garanci të KEDNJ-së duke shkruar në mënyrë publike se: **“(…)Çdo njeriu që do të deklarohej si musliman duhet t’i hiqet shtetësia e Republikës së Shqipërisë, eventualisht e Kosovës dhe të marrë statusin e emigrantit, duke u quajtur emigrant arab.”**

80. Po ashtu, me anë të shkrimit të tyre ata synojnë të dhunojnë rëndë edhe shfaqjen e besimit me anë të kulteve fetare të garantuar në KEDNJ dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, kur shkruan se: **“(…) xhamitë janë fortesat e ushtrisë armike, minaret janë tytat e topave të ushtrisë armike, islamikët praktikantë**

janë ushtarët armiq(...)”.

Detyrimet aktive të shtetit

81. Por cilat janë detyrimet e shtetit në këtë situatë, kur nga shkrimi, botimi dhe përhapja e këtyre artikujve, vihet në rrezik rendi kushtetues shqiptar, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, si dhe bashkëjetesa dhe paqja fetare? Të gjithë këto elementë të cenuar, janë konsideruar në mënyrë të drejtpërdrejtë si vetë baza e një shteti jo vetëm nga Kushtetuta, por edhe si bazat e një rendi juridik evropian, të garantuara nga KEDNJ.

82. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), në garantimin e të drejtave themelore në një shoqëri demokratike, ka theksuar **rolin pasiv dhe mosndërhyrjes të shtetit në ushtrimin e këtyre të drejtave**. Megjithatë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) me anë të vendimeve të saj, ka luajtur një rol të rëndësishëm në tejkalimin e këtij koncepti, duke e vënë theksin në efektivitetin e garantimit të të drejtave të shpallura në Konventë.

83. Në praktikën e Gjykatës theksohet se, **realizimi i të drejtave fetare mund të kërkojë shpesh marrjen nga ana e shtetit, të disa masave aktive**. Shteti duhet të krijojë kushtet për garantimin e ushtrimit të lirshëm të lirisë së fesë. Ai (shteti) përgjigjet për mënyrën në të cilën përplasen bindjet fetare dhe doktrinat.

84. Prandaj sipas jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, shteti mund dhe duhet ta quajë të nevojshme ndërmarrjen e masave represive ndaj formave të caktuara të sjelljes së individëve, medias apo aktorëve të tjerë, duke përfshirë edhe transmetimin e ideve dhe të informacioneve, nëse i konsideron se janë në kundërshtim me respektimin e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit të personave të tjerë. Një gjë e tillë është e përligjur sidomos në rastet e dhunimit të qëllimshëm të frymës së tolerancës ndërfetare, e cila duhet të karakterizojë shoqërinë demokratike.

85. Kështu, sipas Gjykatës së Strasburgut, përligja e shtetit për të garantuar lirinë themelore të besimit fetar, bashkëjetesën fetare dhe rendin publik, mund të shtrihet padyshim edhe ndaj lirisë së shprehjes duke e kufizuar atë.

86. Konkretisht, në vendimin **Otto-Preminger-Institute kundër Austrisë**, Gjykata Evropiane theksoi se: **“(…) personat, të cilët përfitonin nga të drejtat dhe liritë e parashikuara në Nenin 10 (liria e shprehjes), mbajnë mbi vete detyrime dhe përgjegjësi. Ata duhet që në sferën e opinionëve dhe të bindjeve, të shmangin brenda mundësive, shprehjet që në mënyrë të panevojshme i fyejnë të tjeret, duke shkelur të drejtat e tyre (...)**”.

87. Në këtë mënyrë, duke u nisur nga standardet e vendosura nga KEDNJ dhe të zbërthyer qartësisht nga vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shteti shqiptar me anë të organeve të tij kompetente duhet të ndërmarrin menjëherë masa aktive në këtë drejtim. Ai (shteti) duhet në mënyrë të menjëhershme të pengojë përhapjen e shkrimeve të tilla, si dhe të nxjerrë para përgjegjësisë ligjore këdo që dhunon këto standarde të garantuara në një rend juridik demokratik evropian.

88. Masat e ndërmarrja duhet të jenë të menjëhershme dhe efektive, jo vetëm duke penguar efektivisht përhapjen e shkrimeve të tilla të shtetasit Kastriot Myftaraj dhe gazetës ”Sot”, si dhe duke i dënuar ato penalisht apo civilisht, por ata duhet të jene edhe parandaluese, duke izoluar këtë shtetas apo ndaluar veprimtarinë e gazetës, si dhe duke i detyruar që të mos kryejnë më në të ardhmen të tilla veprime antikushtetuese dhe anti konvencionale, veprime të cilat dhunojnë themelet e një shteti të së drejtës.

Marrëveshja: Republika e Shqipërisë-KMSH

89. Liria e ndërgjegjes dhe besimit fetar përveçse nga Kushtetuta dhe KEDNJ në Republikën e Shqipërisë garantohet akoma më tej edhe nga akte të tjera. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka një ligj (formal) specifik për rregullimin e marrëdhënieve midis shtetit dhe bashkësive fetare, apo një ligj organik për

këto të fundit. Përkundrazi, ligji do të konsiderohej një akt i njëanshëm dhe shumë pak në këtë drejtim. **Ky raport për shkak të rëndësisë së veçantë dhe delikatesës që mbart, i është rezervuar vetëm popullit në Kushtetutë, akteve ndërkombëtare të ratifikuara, dhe pëlqimit të dyanshëm të palëve në marrëveshje të posaçme të lidhura ndërmjet tyre. Njëra prej tyre është marrëveshja e lidhur midis shtetit shqiptar dhe Komunitetit Musliman të Shqipërisë.**

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Musliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ratifikuar me Ligjin Nr. 10 056, datë 22.1.2009.

90. Objekti i kësaj Marrëveshje është: **Rregullimi i çështjeve të marrëdhënieve e të bashkëpunimit midis shtetit dhe Komunitetit Musliman të Shqipërisë, në të mirë të secilit dhe të të gjithëve, mbi bazën e parimeve kushtetuese që garantojnë lirinë e shfaqjes dhe të ushtrimit të fesë dhe të bindjeve fetare, si dhe të dëshirës së përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar marrëdhëniet e ndërsjella.**

91. Neni 3 i Marrëveshjes është një nga dispozitat më të rëndësishme të gjithë aktit, pasi vendos **qëllimet themelore të kësaj Marrëveshje**: Sipas këtij Neni: *“Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:*

a) të garantojë realizimin e të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë;

b) të njohë e të garantojë respektimin e të drejtave të Komunitetit Musliman të Shqipërisë, të statutit dhe traditave të tij, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e besimtarëve, respektimin e riteve dhe praktikave tradicionale, të institucioneve dhe strukturave të tij, si dhe personave juridikë të themeluar prej tij, për të zhvilluar lirisht misionin e tyre fetar, edukativ e bamirës;

c) të njohë dhe të garantojë paprekshmërinë e institucioneve muslimane të kultit, për aq sa veprimtaria e tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, me Kushtetutën e ligjet në fuqi, si dhe traditën dhe statutin e Komunitetit Musliman të Shqipërisë;

d) të garantojë lirinë e individit për të ushtruar fenë islame, për ta shfaqur atë

individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare muslimane, ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve përkatëse fetare;

e) të sigurojë lirinë e individit për të mos u ndaluar dhe as detyruar të bëjë pjesë në bashkësinë fetare muslimane, për të marrë pjesë në praktikat, ritet dhe në strukturat drejtuese të Komunitetit Musliman të Shqipërisë.”.

92. Siç vërehet, shteti shqiptar ka detyrimin që të garantojë lirinë themelore të besimit jo vetëm për shkak të Kushtetutës dhe KEDNJ. Por ai ka marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë përsipër një detyrim të tillë edhe nga marrëveshja me Komunitetin Musliman të Shqipërisë, marrëveshje e cila është ratifikuar në Kuvend. Kështu, shteti shqiptar me anë të organeve të tij kompetente duhet të ndërmarrin menjëherë masa aktive në këtë drejtim. Edhe për shkak të kësaj marrëveshjeje (që për nga efektet dhe fuqia juridike renditet mbi ligjet e zakonshme), shteti duhet në mënyrë të menjëhershme të pengojë përhapjen e shkrimeve të tilla, si dhe të nxjerrë para përgjegjësisë ligjore këdo që dhunon këto standarde të garantuara në një rend juridik demokratik evropian.

93. Masat e ndërmarra duhet të jenë të menjëhershme dhe efektive, duke penguar efektivisht përhapjen e shkrimeve të tilla të shtetasit Kastriot Myftaraj dhe Gazetës ”SOT”, sidomos në të ardhmen.

94. Po ashtu, është detyrë e shtetit shqiptar, i cili duhet të vihej në lëvizje jo vetëm me anë të këtij kallëzimi penal, por edhe kryesisht sapo vërejtë që po cenohej rendi juridik i tij. Është shteti shqiptar ai i cili duhet të kryejë çdo veprim procedural dhe material të nevojshëm për të dënuar penalisht këtë shtetas apo ndaluar veprimtarinë e gazetës, si dhe duke i detyruar që mos të kryejë më në të ardhmen të tilla veprime antikushtetuese dhe anti konvencionale, veprime të cilat dhunojnë rëndë themelet e një shteti të së drejtës.

Ligji penal

95. Liria e ndërgjegjes dhe fesë gjen një mbrojtje të veçantë ligjore edhe nga legjislacioni

penal dhe sidomos në **Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë**. Madje në këtë Kod, kësaj lirie themelore i është kushtuar një seksion i posaçëm, konkretisht **Seksioni X**, i titulluar **”Veprat penale kundër lirisë së besimit”**. Konkretisht, gjenden tre dispozita përkatëse, ku secila prej tyre përbën një figurë vepre penale të veçantë, të tilla si: **Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare; Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit; Pengimi i ceremonive fetare.**

Neni 131

Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare

Ndalimi i veprimtarive të organizatave fetare, si dhe krijimi i pengesave për ushtrimin e lirë të veprimtarive të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

96. Kjo vepër penale ka për objekt, mbrojtjen e veprimtarisë së organizatave fetare/bashkësive fetare, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme nga subjekte të përgjithshme apo të veçantë. Vepra penale konsiderohet e konsumuar, nëse subjekti i saj, jo vetëm ndalon veprimtarinë e organizatave fetare/bashkësive fetare, por edhe nëse krijon pengesa në ushtrimin e lirë të kësaj veprimtarie. Një vepër e tillë penale është klasifikuar si krim, dhe dënohet në maksimum deri në tre vjet burgim.

Neni 132

Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit

Shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i objekteve të kultit, kur ka shkaktuar humbjen plotësisht ose pjesërisht të vlerave të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

97. Kjo vepër penale ka për objekt, mbrojtjen e objekteve të kultit të organizatave fetare/bashkësive fetare, nga veprimet e paligjshme, nga subjekte të përgjithshme apo të veçantë. Vepra penale konsiderohet e konsumuar, nëse subjekti i saj, jo vetëm shkatërron objektet e kultit, por edhe nëse i dëmton ato me dashje, dhe si rrjedhim këto objekte kultit kanë humbur plotësisht ose pjesërisht vlerat e tyre.

Një vepër e tillë penale është klasifikuar si krim, dhe dënohet në maksimum deri në tre vjet burgim.

Neni 133

Pengimi i ceremonive fetare

Ndalimi ose krijimi i pengesave që u bëhen personave për të marrë pjesë në ceremonitë fetare, si dhe për të shprehur lirisht bindjet fetare, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

98. Kjo vepër penale ka për objekt, mbrojtjen e lirisë së personave për të marrë pjesë në ceremonitë fetare si dhe për të shprehur bindjet fetare, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme, qofshin këto nga subjekte të përgjithshme apo të veçantë. Vepra penale konsiderohet e konsumuar, nëse subjekti i saj, jo vetëm ndalon personat për të marrë pjesë në ceremonitë fetare si dhe për të shprehur bindjet e tyre fetare, por edhe nëse thjesht krijon pengesa në ushtrimin e lirë të këtyre lirisë. Një vepër e tillë penale është klasifikuar si kundërvajtje penale, dhe dënohet në maksimum deri në një vit burgim.

99. Siç vërehet, shteti shqiptar ka marrë angazhimin që jo vetëm të lejojë shprehimisht lirinë e ndërgjegjes dhe fesë, por edhe ta garantojë atë, duke marrë masa konkrete, madje deri penale, në rast cenimi të tyre. Dispozitat penale të mësipërme, nuk janë gjë tjetër, veçse garanci suplementare ndaj lirisë së ndërgjegjes dhe fesë. Kështu, çdo subjekt i cenuar në mënyrat e mësipërme, mund të vërë në lëvizje autoritetet shtetërore të mbrojtjes së rendit dhe drejtësisë, për të ndaluar veprimet e mësipërme, madje edhe duke i dënuar shkelësit.

100. Megjithatë, veprimtaria e shtetasit Kastriot Myftaraj dhe gazetës **”Sot”**, përveçse vë në rrezik objektet e mbrojtura më sipër, dhe të konsideruara si vepra penale, kjo veprimtari është edhe më e rrezikshme se kaq.

101. **Veprimtaria e tyre cenon një kapitull tjetër vlerash të mbrojtura nga Kodi Penal të cilat janë klasifikuar edhe akoma më të rrezikshme nga ligjvënësi shqiptar. Konkretisht bëhet fjalë për Kapitullin ”Vepra penale**

kundër rendit dhe sigurisë publike”. Këto dispozita janë renditur me qëllim për të mbrojtur rendin dhe sigurinë publike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 265

Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve

Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve raciale, nacionale ose fetare, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja me qëllim përhapjeje e shkrimeve me përmbajtje të tillë, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

102. Kjo vepër penale ka për **objekt**, mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike nga nxitja e urrejtjes apo grindjeve raciale, nacionale apo fetare, me anë të përhapjes së shkrimeve me përmbajtje të tillë. **Shtetasi Kastriot Myftaraj me veprimtarinë e tij, në bashkëpunim me Gazetën "Sot" ka cenuar pikërisht këtë objekt të mbrojtur posaçërisht nga legjislacioni penal.**

103. Nga **ana objektive**, kjo vepër penale quhet e konsumuar sapo autori kryen veprime të tilla aktive duke përhapur shkrime apo artikuj që në formën apo përmbajtjen e tyre, nxisin urrejtjen apo grindjen raciale, nacionale apo fetare. **Në rastin në fjalë, shtetasi Kastriot Myftaraj në bashkëpunim me gazetën "Sot" kanë shkruar dhe përhapur shkrime të tilla të cilat cenojnë rendin dhe sigurinë publike, duke nxitur urrejtjen apo grindjen raciale, nacionale apo fetare, dhe konkretisht ndaj fesë islame dhe besimtarëve muslimanë.**

104. Për këtë shkak, nga ana objektive të dy këta autorë, kanë konsumuar veprën penale **"Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve"**, në bashkëpunim, parashikuar nga Neni 265 dhe 25 i Kodit Penal.

105. Vlen të theksohet se vepra penale e mësipërme është konsumuar nga ana objektive edhe në kushtet e disa rrethanave rënduese. Konkretisht, sa i përket **rrethanave rënduese**, nga faktet e provuara si më sipër, parë nën vështirimin e **Nenit 50 të Kodit Penal**, rezulton se **në rastin në fjalë ekzistojnë një varg rrethanash rënduese**, dhe konkretisht, pikat: **b), ç), gj), h)** të këtij Neni.

"b) kryerja e veprës (...) për të siguruar për vetë ose për të tretët përfitime pasurore, ose çdo lloj përfitimi tjetër material";

106. **Kjo rrethanë rënduese është përmbushur totalisht** nga veprimet e shtetasit Kastriot Myftaraj, pasi në bashkëpunim me gazetën "Sot", **përgjatë gjithë veprimtarisë së tyre të nxitjes me anë të artikujve gazetareskë të urrejtjes dhe grindjeve ndërmjet kombësive racave apo feve, kanë përfituar para nga shitja e gazetës, dhe qëllimi i tyre ka qenë veç të tjerash, përfitimi pasuror në dëm të shtetasve të tjerë.**

"ç) kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë";

107. **Edhe kjo rrethanë rënduese e ligjit penal shqiptar është përmbushur në rastin konkret.** Shtetasi Kastriot Myftaraj rezulton se ka qenë i proceduar dhe dënuar edhe më parë përsëri për krime të tjera të abuzimit të tij me lirinë e shprehjes.

"gj) kryerja e veprës penale në bashkëpunim;

108. Dukshëm, edhe **kjo rrethanë rënduese vërehet qartazi se është përmbushur përgjatë kryerjen së kësaj veprimtarie kriminale.** Konkretisht, shtetasi Kastriot Myftaraj në bashkëpunim me gazetën "Sot" kanë shkruar dhe përhapur shkrime të tilla të cilat cenojnë rendin dhe sigurinë publike, duke nxitur urrejtjen apo grindjen raciale, nacionale apo fetare, dhe konkretisht ndaj fesë islame dhe besimtarëve muslimanë.

"h) kryerja e veprës penale më shumë se një herë";

109. **Edhe kjo rrethanë rënduese vërehet qartazi se është përmbushur përgjatë veprimtarisë kriminale të shtetasit Kastriot Myftaraj në bashkëpunim me gazetën "Sot".** Të dy këta autorë në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë shkruar dhe përhapur disa shkrime të tilla të cilat cenojnë rendin dhe sigurinë publike, duke nxitur urrejtjen apo grindjen raciale, nacionale apo fetare, dhe konkretisht ndaj fesë islame dhe besimtarëve muslimanë.

Konkretisht këtë e kanë bërë jo vetëm në 25 Maj 2010, por e kanë ripërsëritur edhe në datën 28 Maj 2010, si dhe sidomos në datën 02.06.2010.

110. **Subjekte** të kësaj vepre penale **të klasifikuar si krim**, u provua katërçipërisht nga të gjitha aktet e mësipërme procedurale se **janë në bashkëpunim me njëri tjetrin, shtetasi Kastriot Myftaraj si dhe personi juridik Gazeta “Sot”** me botues Arjan Prodani. Shtetasi **Kastriot Myftaraj** nga të dhënat personale të tij, meqenëse është i datëlindjes 02.10.1966, **ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, pra është mbi 14 vjeç, si dhe prezumohet se është juridikisht i përgjegjshëm**, përderisa nuk u provua e kundërta. Po ashtu, edhe personi juridik rezultoi i regjistruar dhe efektivisht ekzistent.

111. Nga ana subjektive, krimi i **“Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”**, në bashkëpunim, parashikuar nga Neni 265 dhe 25 i Kodit Penal, është kryer me faj në formën e dashjes direkte, pavarësisht qëllimit.

112. Nga analizimi i hollësishëm i këtyre artikujve gazetareske, del e provuar tërësisht se shtetasi **Kastriot Myftaraj** në bashkëpunim me **personin juridik Gazeta “SOT”**, kanë konsumuar krimin e **“Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”**, në bashkëpunim, parashikuar nga Neni 265 dhe 25 i Kodit Penal, krim i cili dënohet në maksimum deri në dhjetë vjet burgim.

113. Por shtetasi **Kastriot Myftaraj** në bashkëpunim me **personin juridik Gazeta “SOT”**, kanë konsumuar përveç krimin të **“Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”**, në bashkëpunim, parashikuar nga Neni 265 dhe 25 i Kodit Penal, edhe disa vepra të tjera penale konkurruese. Konkretisht bëhet fjalë për veprat penale **“Thirrja për urrejtje nacionale”** parashikuar nga Neni 266 dhe 25 i Kodit Penal, si dhe **“Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik”**, parashikuar nga Nenet 267 dhe 25 të Kodit Penal. Këto vepra kanë këtë përmbajtje:

Neni 266

Thirrja për urrejtje nacionale

Vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 267

Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik

Përhapja e informatave apo njoftimeve të rreme, me fjalë, me shkrim apo me çdo mënyrë tjetër, me qëllim që të ngjallë një gjendje pasigurie dhe paniku te njerëzit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

114. Të dyja këto vepra penale edhe pse janë në një kapitull me veprën penale të **“Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”**, parashikuar nga Neni 265 i Kodit Penal, në fakt konkurrojnë me njëra tjetrën sepse kanë nën mbrojtje objekte juridikë të veçantë.

115. Në këto kushte, do të kërkonim procedimin penal të shtetasit **Kastriot Myftaraj** dhe personit juridik **Gazeta “Sot”**, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë konsumuar përveç krimin të **“Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”**, kanë konsumuar edhe veprat penale **“Thirrja për urrejtje nacionale”** dhe **“Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik”**, në bashkëpunim, parashikuara nga Nenet 266, 267 dhe 25 të Kodit Penal.

E nderuara Prokurore e Përgjithshme!

Të nderuar prokurorë të Rrethit Gjyqësor Tiranë!

116. Rendi kushtetues shqiptar, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij,

drejtësia shoqërore, si dhe bashkëjetesën fetare, janë të gjithë elementë të cilët janë konsideruar në mënyrë të drejtpërdrejtë si vetë baza e këtij shteti, që nga Preambula e Kushtetutës, deri tek përmbajtja e saj; që nga KEDNJ, deri tek akteve e tjera ndërkombëtare të ratifikuara; dhe që nga marrëveshjet shtet-bashkësi fetare e deri tek Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

117. Shtetasi Kastriot Myftaraj dhe personit juridik Gazeta “SOT”, në bashkëpunim me njëri tjetrin, me anë të shkrimit, botimit dhe përhapjes të disa artikujve të tillë gazetareske, minojnë rëndë këto vlera që përbëjnë themelet e një shteti të së drejtës.

118. Në këto kushte, do të ishte me vend që ndaj këtyre dy subjekte, me qëllim parandalimin e kryerjes të veprave të të njëjtit lloj në të ardhmen, të mund të aplikoheshin masa sigurimi të përshtatshme personale për secilin prej këtyre subjekteve, deri në gjykimin përfundimtar të kësaj çështjeje penale.

119. Konkretisht, ndaj shtetasit Kastriot Myftaraj, meqenëse ka abuzuar në mënyrë të përsëritur me lirinë e shprehjes duke minuar disa herë themelet e shtetit të së drejtës, ndaj tij mund të ndërmerret edhe masa e sigurimit më ekstreme personale e llojit shtrënguese “Arrest me burg”, deri në gjykimin përfundimtar të kësaj çështjeje.

120. Ndërkohë që ndaj personit juridik Gazeta “Sot” me botues Arjan Prodani, mund të merret masë sigurimi personale e karakterit ndalues “a) pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik; apo b) ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.”. Me anë të këtyre masave sigurimi të karakterit ndalues të bëhet e mundur pezullimi i veprimtarisë botuese të Gazetës “Sot” në mënyrë të menjëhershme, sidomos të materialeve që thellojnë më tepër pasojat e veprës penale tashmë të konsumuar plotësisht prej tyre.

E nderuara Prokurore e Përgjithshme znj. Ina Rama!

Të nderuar prokurorë të Rrethit Gjyqësor Tiranë!

121. Së fundi, në emër të gjithë popullit shqiptar i cili gëzon një nga vlerat më të shumë-vlerësuara të tij, bashkëjetesën fetare, do t’iu kërkonim që këtë kallëzim penal jo vetëm ta merrnit në konsideratë, por edhe ta vendosnit në prioritetet tuaja më të larta dhe imediate. Çdo ditë e kaluar, nën këtë situatë provokimesh, nxitjesh për urrejtje dhe dhunë ndërfetare, mund të jetë fatale për të ardhmen e këtij vendi, sidomos në fazën delikate të integritimit Evropian që gjendet Republika e Shqipërisë.

122. Siç është fakt i mirënjohur, bashkëjetesa fetare konsiderohet si një nga vlerat më të rëndësishme të shoqërisë shqiptare, e konfirmuar qartësisht edhe nga ndërkombëtarët në raportet e tyre për Shqipërinë.

123. Kur analizon tërë mozaikun e besimeve në Shqipëri, (4 bashkësi tradicionale plus dhjetëra besime të hyra rishtazi), e kupton vërtet se cila është vlera e vërtetë e bashkëjetesës fetare. Mu për këtë, “bashkëjetesa fetare” konsiderohet aq e rëndësishme nga populli shqiptar, aq sa ajo gjendet e “gdhendur” që në preambul, përkrah disa vlerave të tjera të mëdha të shoqërive demokratike, si; pluralizmi, rendi kushtetues, shteti i së drejtës, etj. Sipas preambulës së Kushtetutës së R.Sh.; “Ne, populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale (...) me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare (...) vendosim këtë Kushtetutë.”

124. Përveçse në preambul, “bashkëjetesa fetare” gjendet përsëri edhe në Nenin 3 të Kushtetutës së R.SH. Risjellja e “bashkëjetesës fetare” edhe në këtë dispozitë normative kushtetuese, e bën lehtësisht të kuptueshme rëndësinë e veçantë të saj, mjafton të përmendim faktin se; në Nenin 3 sanksionohen bazat e shtetit shqiptar.

125. Nga përcaktimet e mësipërme kushtetuese lidhur me “bashkëjetesën

fetare” rrjedh qartë rëndësia e trajtimit të kësaj çështjeje, qoftë si vlerë sociale, qoftë si koncept kushtetues apo si një nga bazat e shtetit. Prandaj trajtimi, ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i ”bashkëjetesës fetare” në shoqërinë shqiptare, lypset që të bëhet me maturi, përderisa përbën (sipas Kushtetutës), një nga bazat e shtetit shqiptar.

126. Maturia duhet të shfaqet nga njëra anë, si nga individët privatë, shoqëria civile, media, ashtu edhe bashkësitë e ndryshme fetare, por sidomos në mënyrë të padiskutueshme, maturia në trajtimin e kësaj çështjeje duhet të shfaqet nga shteti dhe institucionet e tij. Është ky i fundit (shteti) i cili, në rast se ndonjëri prej aktorëve të mësipërm si: individët privatë, shoqëria civile, media; do të cenonin këtë vlerë të rëndësishme kushtetuese, duhet të ndërhyjë për ta ruajtur të paprekur.

127. Prandaj është e domosdoshme që kujtdo dhunues dhe autor të krimeve që kërkon të dalë mbi rendin juridik të këtij shteti, duke bërë presion të hapur edhe ndaj institucioneve të ndjekjes penale dhe të dhënies së drejtësisë, t’i tregohet urgjentisht zbatimi i ligjit. Deklarimet e tij që: “(...) ta harrojë çdo prokuror, gjykatës, se unë do t’i nënshtrohem një hetimi, apo gjykimi të iniciuar nga kryeshefi i megalehjes teknologjike arabisht në Shqipëri, haxhi doktor Selim Muça. Derisa Prokurorja e Përgjithshme, Ina Rama, e ka zyrën të rrethuar nga 10-15 megafonë të tre minareve, të cilët gjenden në një distancë të afërt, të cilët përhapin me forcë megalehjen teknologjike arabisht, është qesharake që të merret në konsideratë çdo vendim i Prokurorisë të drejtuar prej saj.”; duhet të bëjë organet shtetërore që të veprojnë në mënyrën më urgjente të mundshme.

128. Përfundimisht, Ju kërkohet publikisht fillimin, vazhdimin dhe paraqitjen për gjykim, të procedimit penal në ngarkim të shtetasit Kastriot Myftaraj dhe personit juridik Gazeta “SOT”, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë konsumuar krimet: “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”; “Thirrja për urrejtje nacionale” dhe “Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik”, në bashkëpunim, parashikuara nga Nenet 265, 266, 267 dhe 25 të Kodit Penal.

129. Gjithashtu, meqenëse situata është realisht emergjente, Ju kërkohet publikisht edhe:

- Marrjen e masës së sigurimit personal “Arrest me burg” dhe “Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”; deri në gjykimin përfundimtar të kësaj çështjeje, ndaj shtetasit Kastriot Myftaraj; si dhe;
- Marrjen e masës së sigurimit të karakterit ndalues: “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”; apo “Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”; ndaj personit juridik Gazeta “SOT”, me botues Arjan Prodani.

Me respekt,

Forumi Musliman i Shqipërisë

Kryetari

Fisnik Kruja

www.forumimusliman.org
info@forumimusliman.org